



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 767/
18 Prot.

Patos, më 28/04/2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 23 PRILL 2025

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak, Patos

Ora e fillimit: 14:00

Ora e mbarimit: 15:30

Dëgjesë publike me temë: “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Kryetari i bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtor e financave znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj, Drejtor e Urbanistikës znj. Boreta Murati, Dr. Projektve znj. Ermenita Mici, rrëth 48 pjesëmarrës (të rinj, pjesë e KVR, mësues, drejtues të institucioneve arsimore etj).

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2028”, jemi këtu sot për të dëgjuar të gjitha kërkesat që të rintjtë kanë dhe në fund do të

merret parasysh secila nga kérkesat tuaja ose jo. Këtu kemi prezent edhe Kryetarin e bashkisë dhe përfaqësues nga drejtoritë e bashkisë.

Do t'ju lutesha që si gjithmonë të respektojmë rregullat e dëgjesës, gjithsecili para se të kérkoj fjalën duhet të prezantohet me emër, mbiemr pasi takimi rregjistrohet dhe çdo ankesë, propozim apo mendim i juaj do trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi. Edhe njëherë ju



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kérkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

falenderoj për pjesëmarrjen dhe mund të vazhdoni të merrni fjalën ju dhe pastaj Kryetari i bashkisë.

Drejtore e shkollës “Hekuran Maneku”, znj. Marinela Kolici – përvihendje të gjithëve!
Përvihendes kryetarin e bashkisë dhe e përgëzoj për punën dhe rritjen e cilësisë që ka bërë në



**Drejtore e shkollës “Hekuran Maneku”
Znj. Marinela Kolici**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kérkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

shërbime. Kam një kérkesë për shkollën, pasi shkolla jonë është e parikonstruktuar dhe nuk ka palestër, por ambientet sportive të jashtme i kemi në një gjendje relativisht të mirë, por na është ngritur problemi të cilin e kam sjellë disa herë dhe me shkresa zyrtare në bashki, mbi tabelën dhe koshat e basketbollit. Do të ishte mirë që të vendoseshin sa më shpejt sepse janë muajt Maj, Qershor dhe normalisht nxënësit në orën e fiskulturës i duan të zhvillojnë një orë sa më efikase. Dhe një problem tjetër që na ka dalë kohët e fundit, pas erës së fortë javën e kaluar, baxhaja e shkollës sonë është e lëvizshme, për fat të mirë nuk kishte nxënës. Do të ishte mirë që të zgjidhej ky problem, që ta kapin diku dhe të jetë fikse dhë jo e lëvizshme. Kaq kisha, faleminderit!

Drejtore e shkollës “Meleq Gosnishti” znj. Entela Kënaci - përshëndetje të gjithëve!
Përshëndetje i nderuar kryetar! Faleminderit që jemi pjesë e kësaj dëgjese. Keni qenë bashkëpunues me të gjitha institucionet dhe ju falenderoj, sidomos me shkollën “Meleq



**Drejtore e shkollës “Meleq Gosnishti”
zpj. Entela Kënaci**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Gosnishti”. Nga problematikat kryesore janë këndet sportive pavarësisht rikonstrukzionit të fundit që është bërë para 5 vitesh, ne kemi vetëm një palestër, por që nuk është në funksion të plotë për vetë faktin që kemi një numër të madh nxënësish dhe kemi zhvillime të orëve të ndryshme, duke qenë se janë 3 mësues të edukimit fizik. Duam pjesën e rregullimit të mjedisit fizik të jashtëm, duke qenë se pjesa e pasme e shkollës është një ambient që është në dispozicionin tonë, por që nuk ka kushte të mira. Është e betonizuar dhe nuk shërben për zhvillimin e këtyre orëve. Një problematik tjetër është pjesa e lagështirës në pjesën e taracës në katin e 2, është një problem madhor. Gjendja e tualetave dhe pse është shkollë e rikonstruktuar së fundi nuk është e mirë, për pjesën e rrjedhjes së tualetave në pjesën e palestrës, kam bërë dhe një kërkesë para disa ditësh, gjë që sjell një problem për nxënësit që zhvillojnë procesin mësimor. Faleminderit!

Mësues në shkollën “Meleq Gosnishti” z. Lefter Manaj– java që kaloi ka bërë dëme të pjesa e parapetit të shkollës, në pjesën anësore. Era ka shkëputur pjesën e aluminit. Nëse



**Mësues në shkollën “Meleq Gosnishti” z.
Lefter Manaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025.

ndërhyjmë tani do shumë pak materiale për tu rregulluar, se nëse e lëmë për më vonë do të

dojë dhe më shumë. Gjithashtu kërcohët edhe ndërhyrje për prerjen e barit në shkollë dhe për bimët pasi janë rritur shumë dhe kanë nevojë për sistemim.

Nxënëse në shkollën “Muhamet Shehu”, Fjorentina Bregu – përshëndetje! Unë jam



**Nxënëse në shkollën “Muhamet Shehu”
Fjorentina Bregu**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkësave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

nxënëse në shkollën “Muhamet Shehu” dha një nga problematikat është që nuk kemi mjete teknologjike, si laptop për të zhvilluar lëndën e TIK-ut dhe as internet në shkollë.

Mësuese në shkollën “Muhamet Shehu” znj. Besmira Seitaj – përshëndetje! Jam Besmira



**Mësuese në shkollën “Muhamet Shehu”
znj. Besmira Seitaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkësave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Seitaj, mësuese pranë shkollës “Muhamet Shehu” dhe njëkohësisht banore në qytetin e Patosit dhe prind në shkollën “Muhamet Shehu”, pasi kam dy fëmijë. Problematikat e shkollës më shumë i kemi te cështja e sigurisë. Shkolla është e re dhe normalisht nuk mund të kemi probleme të tjera, por ajo që unë kam merak është siguria. Nuk kemi kamera sigurie dhe njëkohësisht nga Ministria u vendos që të kishte oficer sigurie, por shkolla jonë nuk i plotëson kushtet për shkak të numrit të ulët të nxënësve. Ndoshta ndonjë polic bashkiak duhet të jetë pranë ambientit të shkollës.

Mësuesë në shkollën “Muhamet Shehu”, znj. Vjollca Kasaj- përshëndetje! Unë jam mësuesë në shkollën “Muhamet Shehu”, por njëkohësisht edhe anëtare e Këshillit Bashkiak. Problemin e parë po e ngrë në kuadër të shkollës, pasi pas rikonstruksionit ajo shkollë ka nevojë për stola në ambjentin e jashtëm në mënyrë që të qendrojnë nxënësit. Gjithashtu kërkojmë edhe mbështetje lidhur me kabinetet e shkollës pasi na ka ardhur bazë materiale e



**Mësuesë në shkollën “Muhamet Shehu”
znej. Vjollca Kasaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

re, por janë disa kabinete që nuk kemi tavolina dhe banka për të kryer veprimtaritë mësimore.

Mësuese në shkollën “Meleq Gosnishti”, znj. Adelina Shpërdheja- Përshendetje! Shkolla jonë ka qenë shkolla e parë që është rikonstruktuar dhe nuk janë marrë parasysh shkallët e emergjencës. Janë mbi 300 e disa nxënës që dalin nga vetëm një derë dhe në orën e pushimit shkaktohet një rrëmujë e madhe me nxënësit. Stolat gjithashtu janë një problem edhe për



**Mësuese në shkollën “Meleq Gosnishti”
znej. Adelina Shpërdheja**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

shkollën tonë pasi të gjithë nxënësit qendrojnë në këmbë në oborr dhe në orën e pushimit e hanë ushqimin në këmbë.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Shkallët e emergjencës janë shkallë të cilat funksionojnë në rastë emergjente si zjarri, tërmeti etj. Nuk mund të janë shkallë që përdoren çdo ditë për hyrje daljet e nxënësve. Ndoshta do ju duhet ndonjë hapje tjetër osë ndonjë derë tjetër në mënyrë që të përballohet dalja e nxënësve njëkohësisht.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Mësuese në shkollën Oficinë, z. Dorina Manaj– përshendetje! Unë jam mësuese në



**Mësuese në shkollën Oficinë
z. Dorina Manaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

shkollën vartëse në oficinë dhe ne kemi disa probleme edhe pse jemi një shkollë shumë e vogël. Ambjentet e brendshëm kanë një ndriçim shumë të dobët. Ngrohjen na e siguruat këtë vit dhe shumë faleminderit pasi nxënësit nuk patën problem në dimër. Dërrasat e zeza jemi munduar vet të ndërhyjmë dhe t'i rrugullojmë, pasi janë jashtë përdorimit. Ambjenti i jashtëm është i pashtuar dhe jo i përshtatshëm për të luajtur fëmijët. Atu ka edhe pemë të paprera mirë që kanë ngelur trungu vetëm dhe janë problem pasi fëmijët rrezikojnë të vriten. Gjithashtu edhe bimët janë problem në oborrin e shkollës tonë pasi ka shumë bar dhe bimë të tjera dhe rrezikojnë të dalin insekte dhe zvarranik të cilët mund të dëmtojnë nxënësit. Ne jemi munduar të pastrojmë dhe sistemojmë edhe vet duke huazuar mjete pune, por kemi nevojë për ndërhyrje nga ana juaja. Një problem tjetër janë edhe baza materiale që janë të vjetra dhe të dala jashtë përdorimit, por duhen hequr dhe duhen larguar sepse kanë mbetur në korridorin e shkollës.

Zv/ Drejtoresh në shkollën “Sotir Çapo”, znj. Elsa Thanasi– përshendetje të gjithëve! Ne kemi një problem shumë të rëndësishëm siç është trasnporti i nxënësve pasi kemi shumë nxnënës që dëshirojnë të vijnë në shkollën tonë për të vazhduar shkollën e mesme, por duke qenë së nuk ka transport për disa zona kjo e bën të pamundur dhe ata zgjedhin të studiojnë në Fier më mirë pasi e kanë më të thjeshtë pjesën e transportit. Për të ardhur deri në Zharrëz ata kanë një kosto më të lartë pasi duhet të marrin dy autobuza, kurse për Fier marrin vetëm një autobuz dhe normalisht që nxënësit zgjedhin koston më të lirë. Kemi edhe problemin e ujit pasi ne kemi një pompë zhytëse dhe ne shumë herë mbetëmi pa ujë pasi ajo bllokohet. Na duhet një zgjidhej që të kemi ujë çdo herë. Gjithashtu problemin e stolave e kemi edhe ne.




**Zv/ Drejtoresh në shkollën “Sotir Çapo”
znj. Elsa Thanasi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkeseve prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Nxënëse në shkollën “Muhamet Shehu, Glodea Myftaraj– përshendetje! Në shkollën tonë



**Nxënëse në shkollën “Muhamet Shehu
Glodea Myftaraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkeseve prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

ne kemi një ungesë të titutjve të librave dhe ka nevojë për pasurim të këtyre titujve pasi mungojnë shumë autorë dhe ne nuk kemi mundësi të lexojmë.

Mësues në shkollën “Meleq Gosnishti” z. Lefter Manaj – në kemi edhe një problem me ujin e shiut në shkollë pasi kur bie shiu mblidhet i gjithë te shkallët e shkollës dhe nxënësit

nuk kalojnë dot. Aty nuk ka hekur që të presi ujin dhe në duhet ndonje pritë te shkallët hyrëse të shkollës që të mbaj ujin.



**Mësues në shkollën “Meleq Gosnishti”
z. Lefter Manaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Drejtoresh e shkollës “Meleq Gosnishti”, znj. Entela Kënaci- Ne kemi edhe një mungesë në shkollën tonë që është ajo e rojës ditës. Këtë detyrë po e luan sanitaria e shkollës, por kjo nuk është normale pasi ajo duhet të merret edhe detyra të tjera.



**Drejtoresh e shkollës “Meleq Gosnishti”
znj. Entela Kënaci**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Mësuese e shkollës “Sadush Devishi”, znj. Trëndelina Faslliaj- përshëndetje! Ne kei një



**Mësuese në shkollën Sadush Devishi
znj. Trëndelina Faslliaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

problem me çatinë e shkollës të cilin e kemi ngritur dhe më parë. Çatia pikon dhe nuk po mundemi të zhvillojmë orët mësimore. Klasat kanë filluar të dëmtohen dhe lagështia dhe ky është një problem që duhet të zgjidhet.

Nxënëse në shkollën “Muhamet Shehu”, Estrela Shusha- përshendetje! Baza materiale e shkollës tonë është e një cilësie shumë të dobët. Dërrasat, karriget dhe bankat përvèç se janë të pamjaftueshme janë cilësi e dobët. Bankave u dalin vidat dhe lëvizin.



**Nxënëse në shkollën “Muhamet Shehu”
Estrela Shusha**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro – përshendetje! Më vjen mirë që ju keni adresuar kërkesat tuaja lidhur me ambjentet e shkollave. Lidhur me shkollën “Sotir Çapo” e cila ka fituar edhe projektin për tu financuar dhe besoj se do të përfundoj vitin tjetër nëse procedurat nuk vonojnë. Është një projekt shumë i bukur dhe do të jetë një shkollë shumë ndryshe nga të gjitha shkollat e tjera. Lidhur me fondin për mirëmbajtjen e shkollave mund të themi se është një fond jo i madh të cilin do të mundohemi ta rrisim si fond. Baza materiale vendoset që në fillim të verës dhe kur kthehen fëmijët në shkollë fillojnë prishen materialet. Te kjo pjesë duhen ndryshuar procedurat për mirëmbajtjen e shkollave që të bëhet gjatë gjithë viti dhe jo vetëm një herë në vit. Për sa i përket stolave të shkollave ne tani po bëjmë një blerje stolash dhe në pjesën më të madhe të shkollave do të vendosim disa stola. Mbi materialet, si laptopi në dijenin time janë materiale që i mundëson ministria dhe jo bashkia. Për sa i përket sigurisë në shkolla, te shkolla “Muhamet Shehu” ka kamera rruge, por jo brenda në shkollë. Lidhur me shkallën e emergjencës ose me një dalje të dytë do ta shqyrtojmë si mundësi se çfarë mund të sistemojmë. Mbi mirëmbajtjen e hapësirave me bar dhe bimë do të dërgojmë punëtorë të Agjencisë së Shërbimeve Publike për të ndërhyrë sa më parë në ambjentet ku është kjo nevojë në shkolla. Ndriçimi te shkolla në Oficinë do dërgojmë punëtorët për të ndërhyrë dhe për të siguruar një ndriçim sa më të mirë për të nxënësit. Lidhur me transportin nga Belina në Zharrëz duhet të shikojmë mundësinë për të ngritur edhe një bashkëpunim me ZVA ose më kompaninë e transportit Arjani Travel ku të shikojmë se çfarë zgjidhje mund të

na siguroj që të kaloj në Zharrëz te shkolla. Pjesa e rojes së shkollës që u kërkuua duhet ta diskutoj këtë problem që ju keni dhe të mundohemi ti japim një zgjidhje. Uji në Zharrëz është duke u punuar edhe me linjën e ujësjellsit dhe projektin që ata kanë, prandaj do duhet të tregohemi pak të duruar deri sa të përfundoj ky proces. Lidhur me problemin e tituve të librave më vjen shumë mirë që ju keni kërkesa të tilla dhe kjo duhet vlerësuar. Për mendimiun tim është mirë që në një shkollë të sjellësh libra se sa një stolë. Më vjen mirë që ka nnxënës që lexojnë libra. Do ju lutesha që të gjithë ju si shkolla të sillnit kërkesat tuaja për titujt e librave që ju duhen në shkolla duke u konsultuant edhe me mësuesit e letërsisë dhe me të gjithë nxënësit. Do shikojmë mundësinë që titujt që do të blihen do të shkojnë në shkolla dhe një kopje në bibliotekën e qytetit. Prandaj në do të dyfishojmë buxhetin e blerjes së librave.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Mësues në shkollën “Sotir Kola”, Z. Mustafa Demiraj- Shkolla jonë ka nevojë për ambjent të jashtëm, por edhe për shumë gjëra të tjera. Edhe mirëmbajtja e shkollave duhet bërë në periudhën kur nuk ka nxënës pasi shkaktojnë problem dhe zhurëm në procesin mësimor.




**Mësues në shkollën “Sotir Kola”
Z. Mustafa Demiraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Këtë pjesë unë e thashë dhe më herët dhe do të mundohemi ta zgjidhim. Gjithashtu ne duhet edhe të ndërgjegjësohem që të mirëmbajmë bazën materiale të shkollave bashkë me mësuesit dhe nxënësit. Lidhur me izolimin e shkollave do ta zagjidhim dhe do të ndërhyjmë duke rregulluar ato pjesë që kanë nevojë për izolim. Ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe gjithë kërkesat apo problematikat që ju sollët.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

“Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028”

Prill 2025

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Nëse nuk keni më pyetje apo kërkesa do ta deklaroja të mbyllur këtë dëgjesë publike. Ju falenderoj për pjesëmarrje tuaj!



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028”

Prill 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

